

**DEKLARATË E SHOQËRISË TETE ALBANIA NË
LIDHJE ME KËRKESËN E KONFEDERATËS SË
SINDIKATAVE TË SHQIPËRISË**

Në vijim të zhvillimeve të fundit që përfshijnë Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë, shoqëria “TETE Albania Tunnel and Mining” sh.a. dëshiron të sqarojë opinionin publik dhe institucionet shtetërore lidhur me një sërë ngjarjesh që lidhen me Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë dhe z. Kol Nikollaj.

1. Lidhur me kërkesën për nisjen e bisedimeve.

Më **18.09.2025**, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, nën drejtimin e z. **Kol Nikollaj**, i është drejtuar shoqërisë “TETE Albania Tunnel and Mining” sh.a. me kërkesë për fillimin e bisedimeve për nënshkrimin e **Kontratës Kolektive të Punës**.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur u konstatua se kjo kërkesë ishte **e paplotë në dokumentacion** sic kerkohet nga neni 163 e vijues të **Kodit të Punës**. Për shkak të kësaj mungese, shoqëria **nuk** ishte në gjendje të verifikonte nëse Konfederata kishte në anëtarësinë e saj punëmarrës të shoqërisë “TETE Albania”. Ky verifikim paraprak është **detyrim ligjor për ne**, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të punëmarrësve, pasi ligji kërkon që bisedimet dhe lidhja e kontratës të zhvillohen me sindikatën që ka **më shumë anëtarë** nga punonjësit e ndërmarrjes.

Përveçse Konfederata nuk paraqiti **asnjë provë** mbi anëtarësinë (*siç kërkohej nga ligji - neni 163 e vijues të K.P.*), nuk kishte paraqitur as provë që vërtetonte z. **Kol Nikollaj** mbante ende **mandatin e Presidentit** të Konfederatës. Vendimi i dorëzuar pranë nesh tregonte se **mandati i tij kishte përfunduar në vitin 2024**. Këto janë elemente thelbësore për vlefshmërinë e përfaqësimit, për të cilat Konfederata duhej të na kishte informuar paraprakisht, në mënyrë që më pas—siç kërkon ligji—palët të uleshin në bisedime.

2. Qendrimi i shoqërisë dhe ftesa për bashkepunim

Megjithë mangësitë e konstatura, shoqëria “TETE Albania” është treguar vullnet-plotë për të bashkëpunuar. Më **07.10.2025**, i jemi drejtuar Konfederatës me **shkresë zyrtare**, duke kërkuar **plotësimin e dokumentacionit** përkatës për fillimin e një dialogu institucional. Deri më sot, Konfederata ka **refuzuar hapur** të paraqesë çdo provë që vërteton pjesëmarrjen në anëtarësinë e saj të punëmarrësve të shoqërisë “TETE Albania”. Kjo është provë **thelbësore** për të përcaktuar nëse Konfederata është subjekti sindikal i duhur për zhvillimin e bisedimeve sipas nenit 164 të Kodit të Punës. Për më tepër, vetë dokumentacioni i Konfederatës shpreh se anëtarësia e saj përbëhet nga **organizata të tjera sindikale**, e jo vetëm nga punëmarrësit, gjë që e bën edhe më të domosdoshëm verifikimin e **përfaqësueshmërisë**.

3 Organizimi i një greve të paligjshme

Në mungesë të informacionit të kërkuar dhe cdo përgjigjie ndaj ftesës për dialog, Konfederata organizoi një **greve të paligjshme** në datat **08–10.10.2025** pa njofti **paraprak**, siç kërkohej nga nenet 197/1 të Kodit të Punës. Një numër i vogël punëtorësh u grumbulluan duke pretenduar se z. **Albert Bushpreni** ishte larguar nga puna për shkak të pjesëmarrjes në sindikatë. Ky pretendim është **i pabazë**. Z. Bushpreni është shkarkuar nga detyra pasi ka **shkelur procedurën e raportimit dhe hetimit të incidentit në punë**, duke mos paraqitur deklaratën për një aksident të ndodhur në minierë ndërkohë që ushtronte detyrën si **përgjegjës turni**, si dhe ka **penguar aktivisht** hetimet e brendshme mbi shkaqet e aksidentit. Këto shkelje përbëjnë rrezik serioz për **shëndetin dhe sigurinë në punë**.

4. Shkeljet procedurale të Konfederatës

Shoqëria thekson se greva është **organizuar pa njoftime paraprake, pa dialog social, dhe në kundërshtim të hapur me nenet 197 e vijues të Kodit të Punës**. Për më tepër, z. **Kol Nikollaj** ka **refuzuar** të përcjellë dokumentacionin e kërkuar nga ligji dhe ka **mohuar bashkëpunimin**, duke ushtruar presion nëpërmjet grevave të paligjshme, të organizuara në kushtet kur: (i) nuk janë zhvilluar **bisedime paraprake**; (ii) nuk është ndjekur një **proces i mirëfilltë ndërmjetësimi**; dhe (iii) nuk janë zbatuar **procedurat e pajtimit**.

Përveç shkeljes së hapur të ligjit, Konfederata **nuk ka përcjellë asnjë kërkesë konkrete** të punëmarrësve; për pasojë, përveçse të paligjshme, grevat janë edhe **pa objekt të qartë**, duke e bërë të pamundur për shoqërinë të kuptojë kushtet apo kërkesat e pretenduara të punëmarrësve.

5. Qendrimi përfundimtar i shoqërisë

Shoqëria “TETE Albania” ka qenë gjithnjë në mbështetje të punëmarrësve të saj dhe ka kërkuar vetëm respektimin e ligjit. Shoqëria dënon çdo veprim që synon të anashkalojë procedurat ligjore, si dhe çdo veprim abuziv të përsëritur që pengon punën në minierë, i shkakton dëm ekonomik shoqërisë dhe cenon interesat e vetë punëmarrësve që Konfederata pretendon të përfaqësojë.

Shoqëria “TETE Albania” mbetet e gatshme për **dialog** konstruktiv dhe social sapo të paraqitet dokumentacioni i plotë ligjor dhe të respektohen **procedurat e parashikuara** nga legjislacioni në fuqi.

TETE Albania Tunnel and Mining sha

Tiranë më 13 Tetor 2025